



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance			
Arkiva - Arhiva - Archive			
Nr. i Org. Org. Ind. / Org. Unit	04	Nr. Prot. Br. Prot. / Prot. No.	55-1
Nr. i fjalëve Broj stranica / No. pages	5	Data Datum / Date	11.06.2020
Hyrëse	PRISHTINË/A		

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Departamenti i Auditimit të Brendshëm - Departament Interne Revizije - Internal Audit Department

REFERENCË:	19/2020				
PËR/ZA/TO:	Rufki Suma, Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit				
CC:	Hykmete Bajrami, Ministre në Ministrinë e Financave				
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Xhevat Bekteshi, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Brendshëm				
NGA/OD/FROM:	Fatime Jahiu, Udhëheqëse e ekipit				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti final i auditimit të Brendshëm i Komunës së Hanit të Elezit				
Nr. i zyrës:	27	Lokacioni:	Rr: Tring Smajli 15	Data:	11.06.2020
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY WE DISCUSS					
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION	v				
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

Të nderuar,

Të bashkangjitur keni Raportin Final të Auditimit Brendshëm, bashkë me objektivat kryesore për dhënien e mendimit lidhur me "Funksionimin e Komunës së Hanit të Elezit"

Janë diskutuar të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna në Draft raport me menaxhmentin.

Kemi pranuar komentet me shkrim, prandaj Draft raporti finalizohet me komentet e menaxhmentit.

Raportit final ia bashkangjesim edhe Planin e Veprimit me informata kthyesë nga menaxhmenti për zbatimin e rekomandimeve dhe aftatin e përbushjes së rekomandimeve.

Shpresojmë që rekomandimet tona janë praktike dhe mendojmë se do të jenë lehtë të zbatueshëm, prandaj në të ardhmen presim të punojmë me ju për t'u siguruar në zbatimin e rekomandimeve.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Departamenti i Auditimit të Brendshëm - Departament Interne Revizije - Internal Audit Department

Raporti është konfidencial

RAPORTI FINAL I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

FUNKSIONIMI I KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

Qershor, 2020

BAZUAR NË PLANIN VJETOR	Për vitin 2020 të Departamentit të Auditimit të Brendshëm
ORGANIZATA E AUDITUAR:	Komuna e Hanit të Elezit
PROGRAMI / PROJEKTI / SISTEMI OPERACIONAL:	Organizimi dhe funksionimi i Komunës, Buxheti, shpenzimet, menaxhimi i pasurisë
LLOJI I AUDITIMIT	Sistemet/Pajtueshmëria
FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT	01 Janar-31 Dhjetor 2019
KOHËZGJATJA E AUDITIMIT:	Data e fillimit: 05.02.2020 Data e draft raportit: 13.05.2020 Data e raportit final: 11.06.2020
UDHËHEQËS I AUDITIMIT:	Fatime Jahiu
ANËTARET E EKIPIIT TE AUDITIMIT:	Isuf Demiri

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4
1. Hyrje	5
2. FUSHËVEPRIMI	5
3. OBJEKTIVAT E AUDITIMIT	5
4. TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET	6
4.1 Organizimi dhe Funksonimi i Komunës.....	6
4.1.1 Kuvendi Komunal.....	7
4.2 Planifikimi i buxhetit.....	7
4.2.1 Kërkesat për ndarje buxhetore.....	7
4.3 Realizimi i shpenzimeve	9
4.3.1 Investimet kapitale	10
4.3.2 Prokurimi.....	12
4.3.3 Bashkëfinancimet.....	14
4.4 Autorizimi, regjistrimi, pranimi i shpenzimeve.....	15
4.5 Pasuria.....	16
5. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË DAB.....	17
6. KONKLuzionET.....	17
7. PLANI I VEPRIMIT	18
8. FALËNDERIMET.....	18

Aneksi I - Të gjeturat, rekomandimet dhe komentet e menaxhmentit

Aneksi II- Plani i Veprimit

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Qëllimi i auditimit të brendshëm në Kuvendin Komunal të Hanit të Elezit ka qenë analiza, ekzaminimi, verifikimi i procedurave dhe kontrolleve të zbatuara nga menaxhmenti për të siguruar se buxheti, shpenzimet dhe pasuria janë menaxhuar drejtë në mënyrë efikase, efektive dhe me kosto të arsyeshme për arritjen e objektivave të Komunës.

Objektivat tona për këtë auditim janë përcaktuar në pajtim me menaxhmentin e Komunës dhe vlerësimin e rreziqeve se sistemet ekzistuese të kontrollit janë adekuate.

Gjatë auditimit kemi ekzaminuar, rishikuar dhe testuar dokumente të ndryshme duke filluar nga legjislacioni, funksionimi i komunës, kërkesat dhe aprovimi i buxhetit për vitin 2019, realizimi i shpenzimeve kundrejt buxhetit dhe pasuria.

Ekzaminimet tona janë mbështetur në intervista, analiza të dokumentacionit të ofruar dhe testeve të kryera.

Të gjeturat nga auditimi janë të përmbledhura si në vijim:

- Administrata komunale funksionon sipas legjislacionit në fuqi, ka të miratuar strukturën organizative dhe Statutin e saj;
- Kuvendi Komunal (KK) gjatë vitit 2019 ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta. Për çdo takim të mbajtur mbahen procesverbalet. KK ka përgatitur Raportin vjetor të punës;
- Planifikimi i Buxhetit iu është përmbytur kritereve të përcaktuar në Qarkoret buxhetore;
- Nuk është funksionalizuar Çerdhja e fëmijëve edhe pse ekziston objekti me të gjitha pajisjet e nevojshme. Në mungesë të stafit çerdhja është jashtë funksionit;
- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) ka numër të vogël të stafit profesional për dhënie të shërbimeve qytetarëve;
- Buxheti aktual ka rritje krahas buxhetit fillestar, kjo rritje ka ardhur nga bartja e të hyrave vetanake të vitit 2018, bartja e granteve, bartja e huamarrjes për arsim, granti nga Qeveria Japoneze dhe transferi i mjeteve të huadhënies nga Komuna në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Buxheti është ekzekutua 97.74% krahas buxhetit aktual;
- Pjesa më e madhe e shpenzimeve është realizuar në investime kapitale si: ndërtim të rrugëve lokale, në trotuare, fusha dhe objekte sportive, kanalizim etj;
- Sistemi i Projekteve të Investimeve Publike (PIP) ka të dhëna të regjistruara vetëm për projektet kapitale që janë të nevojshme për planifikimin e buxhetit Tabela 4.2 e Ligjit të buxhetit vjetor, por në sistem nuk janë regjistruar të dhënat për progresin dhe përfundimin e projektit;
- Plani i menaxhimit të kontratave nuk është plotësuar siç duhet. Formulari në shumicën e rasteve është plotësuar formalisht (me nënshkrim të kontratës dhe nuk dihet kur është përfundua projekti);
- Komuna ka përlituar mjete nga ministritë e linjës nga bashkëfinancimet, mirëpo dokumenti i Marrëveshjes së mirëkuptimit kanë paqartësi sidomos në obligimet në mes të palëve, zgjidhja e mosmarrëveshjeve, bartjen e pronës dhe ka vonesa në kapitalizimin e pasurisë ;
- Është bërë inventarizimi i pasurisë nga komisioni dhe ka përgatitur raportin. Komisioni i

- vlerësimi është caktua por nuk ka përfundua punën. Komisioni i tjetërsimit të pasurisë ka kryer punën dhe ka përgatitur Raportin për tjetërsimin e pasurisë;
- Për regjistrimin e të dhënave për pasurinë nën vlerën 1,000.00€ në Sistemin e-pasuria gjatë vitit 2019, zyrtarët kanë pasur problem në futjen e të dhënave në sistem.

Vlerësimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm

Vlerësimi	Përshkrimi	Niveli i shqetësimit
Nevojitet përmirësim	Janë vërejtur të gjetura të theksuara në disa aktivitete të detajuara të kontrollit, megjithëse korniza e përgjithshme e kontrollit është në funksion.	Ka vend për përmirësim

1. HYRJE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 06/L-021 për kontroll të brendshëm të financave publike, në pajtim me Rregulloren QRK Nr. 01/2019, neni 5 paragrafi 4 për themelimin dhe zbatimin e funksionimit të Auditimit të Brendshëm dhe në bazë të Planit Vjetor të Departamentit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2020 është kryer auditimi në Komunën e Hanit të Elezit.

Korniza Ligjore i shfrytëzuar gjatë auditimit:

- Ligji Nr. 03/L -048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi (LMFPP) dhe plotësim ndryshimet e tij;
- Ligji Nr. 06/L-133 për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019;
- Ligji Nr. 03 / L- 040 për Vetëqeverisjen Lokale (LVL);
- Ligji Nr. 03/ L – 049 për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL);
- Statuti i Komunës
- Rregullorja MF – Nr. 01/2019 për menaxhimin financiare dhe kontrollin;
- Rregullorja Nr. 02/2017 për sistemin e menaxhimit të performancës së Komunave (MAPL);
- Rregullorja (KHE) 01/Nr. 17/2009 për punën e Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit

2. FUSHËVEPRIMI

Fushëveprimi i auditimit përfshinë periudhën 01 Janar- 31 Dhjetor 2019.

3. OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

Të sigurohet se sistemet e kontrollit i përmbushin si duhet objektivat e cekura në vijim dhe të dakorduara me menaxhmentin:

- Organizimi dhe funksionimi i Komunës;
- Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit;
- Autorizimi, regjistrimi, pranimi dhe monitorimi i shpenzimeve;
- Ruajtja e pasurisë;

4. TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET

4.1 Organizimi dhe Funksionimi i Komunës

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale përcaktohet statusi ligjor i komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale organizimi dhe funksionimi i organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimit ndër komunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.

Komuna e Hanit të Elezit funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Për funksionimin dhe menaxhimin më të mirë të aktiviteteve që dalin nga objektivat e komunës, përgatitet Struktura organizative. Në përputhje të saj bëhet ndarja e detyrave dhe përgjegjësive, që tregon linjat organizative, të kontrollit, përgjegjësive, llogaridhënies, marrëdhëniet horizontale dhe vertikale.

Komuna ka miratuar Statutin, Rregulloren e punës, rregulloret tjera dhe vendime për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive me qëllim të arritjes së objektivave, gjithashtu ka miratuar Strukturën Organizative (Organogramin).

Administrata komunale ka këtë strukture organizative, Kryetari dhe stafi mbështetës i zyrës. Në kuadër të zyrës së Kryetarit funksionojnë: zyra e personelit, zyra ligjore, zyra e prokurimit, zyra për të drejtat e njeriut, zyra për barazi gjinore.

Administrata komunale funksionon me këto drejtori për:

- Administratë;
- Buxhet dhe financa;
- Urbanizëm, kadastër dhe mbrojtje të ambientit;
- Arsimit, kulturë, rini dhe sport;
- Shëndetësi dhe mirëqenie sociale;
- Shërbime publike dhe emergjenca;
- Bujqësi, zhvillim rural dhe pyje;
- Zhvillimi ekonomik.

Komuna ka përgatitur Listën e rreziqeve komunale për vitin 2020-2022, Pyetësorin e vlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për periudhën Janar 2018-Janar 2019.

Komuna ushtron kompetenca vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara.

Në kuadër të komunës funksionon Web faqja komunale dhe rrjeti social (face book) që jepen

informacione për qytetarët rreth zhvillimit të aktiviteteve komunale, faqja zyrtare e komunës dhe rrjeti social janë të pajisura me informata dhe janë transparente për publikun.

4.1.1 Kuvendi Komunal

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale duhet të funksionoj Kuvendi Komunal. Numri i anëtarëve në kuvendin e komunës duhet të jetë proporcional, varësisht nga numri i qytetarëve në komunë.

Kuvendi Komunal (KK) është organi më i lartë në komunë, është i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale. Në kuadër të kuvendit funksionojnë dhe tri komitete: për politikë dhe financa, për komunitete dhe konsultativ.

Kuvendi i Komunës ka 15 anëtarë me mandat 4 vjeçare.

Gjatë vitit 2019 Kuvendi i Komunës ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta. Të gjitha mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun dhe janë njoftuar qytetarët. Takimet e Kuvendit ftohen nga Kryesuesi në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës. Njoftimet për takime përcillen përmes sekretarisë së Kuvendit tek anëtarët komunal.

Për çdo takim të mbajtur mbahet procesverbali i cili është i nënshkruar nga Kryetari i Kuvendit dhe procesmbajtësi. Procesverbalet janë miratuar nga anëtarët e Kuvendit.

Gjatë vitit 2019 Kuvendi ka marrë 42 vendime, ka aprovuar katër (4) Rregullore dhe ka përgatitur Raportin vjetor të punës për vitin 2019.

Mund të themi se sistemi i kontrollit funksionon.

4.2. Planifikimi i buxhetit

Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin komunave për vitin 2019 bazohen në Ligjin për Financat Publike Lokale (LFPL) dhe në tabelën e projeksioneve makro-fiskale të përgatitur nga Ministria e Financave siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi (LMFPP).

Kufijtë buxhetor për komunat për periudhën 2019-2021 janë aprovuar nga Komisioni i Granteve dhe janë pjesë integrale e KASH-it 2019-2021. Projektet kapitale të filluara në vitet e kaluara të cilat kanë krijuar obligime kontraktuale mbi mjetet e buxhetuara për OB kanë përparësi në ndarjet buxhetore.

Burimet e financimit Komunal për vitin 2019-2021 janë: granti i përgjithshëm, granti specifik për arsim para universitar, granti specifik për shëndetësi primare, financimi për shëndetësi sekondare, financimi për shërbimet rezidenciale, projeksionet e të hyrave vetanake komunale 2019 dhe parashikimet 2020-2021, financimi nga Huamarrja.

4.2.1 Kërkesat për ndarje buxhetore

Ministria e Financave – Departamenti i Buxhetit për vitin 2019 ka lëshuar Qarkoren buxhetore Nr. 2019/1 me 15 Maj 2018 dhe i ka njoftuar të gjithë Kryetarët e Komunave, drejtorët e drejtorive komunale dhe zyrtarët për buxhet. Qarkoret japin udhëzime për hartimin e buxhetit për vitin 2019 dhe parashikimet 2020-2021 dhe kufijtë fillestar buxhetor.

Komuna e Hanit të Elezit ka 9,403 banorë, me 83 km², mësimet i ndjekin 1,907 nxënës, 134 mësimdhënës dhe stafi mbështetës. Për nevoja të shëndetësisë funksionon Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF).

Tabela Nr. 1 Kërkesat për ndarje buxhetore dhe kufijtë buxhetor për vitin 2019

Burimet e financimit	KASH 2019-2021	Qarkorja e Nr. 2019/1 dhe Qarkorja Nr.2019/2
Granti i përgjithshëm	1,394,122.00	1,394,122.00
Granti specifik i arsimit	924,342.00	924,342.00
Granti specifik për shëndetësi primare	282,090.00	282,090.00
Të hyrat vetanake	289,129.00	289,129.00
Financimi nga Huamarrja në arsim	3,671.00	3,671.00
Financimi nga Huamarrja në shëndetësi	22,567.00	22,567.00
Totali i buxhetit	2,915,921.00	2,915,921.00

Nga të dhënat në tabelë shohim se të dhënat në KASH-it dhe qarkoret buxhetore burimet e financimit janë të njëjta.

Komuna duke u bazuar në Qarkoren e parë buxhetore ka përgatitur Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB) në Qershor 2018 duke iu përmbajtur kufijve buxhetor, janë shqyrtuar prioritetet nga drejtoritë dhe duke i përcaktuar kufijtë fillestarë specifik të drejtorive.

Me 31 Korrik 2018 Ministria e Financave ka lëshuar Qarkoren e dytë buxhetore ku ka përcaktuar strukturën e shpenzimeve për buxhetin komunal për vitin 2019 dhe parashikimet 2020-2021. Ku janë paraqitur numri i punëtorëve dhe kategoritë ekonomike të shpenzimeve dhe burimet e financimit janë të njëjta.

Projekt buxheti planifikohet duke përdorur dy sisteme:

1. Sistemi e Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit (SZHMB-BDMS) - në këtë sistem regjistrohen të gjitha shpenzimet rrjedhëse (Pagat dhe mëditjet, Mallrat dhe shërbimet, Shpenzimet komunale, Subvencionet dhe transferet) dhe parashikimet afate mesme (2019-2021);
2. Sistemi i PIP-it – në këtë sistem regjistrohen investimet kapitale dhe parashikimet afatmesme (2019-2021). Zbatimi i projekteve kapitale është i rëndësishëm të bazohet në listën e prioriteteve me ndikim në përmirësimin e rrjetit të infrastrukturës së shërbimeve, përmirësimin e kushteve në arsim, sistemin social, shëndetësor dhe mjedisor.

Buxheti i Komunës është i ndarë në 11 programe dhe 17 nën programe.

Komuna ka mbledhë informatat nga të gjitha njësitë kërkuese për hartimin e propozim buxhetit për vitin 2019-2021, ka mbajtur dëgjimet buxhetore me qytetar. Buxheti është diskutua në Komitetin për politik dhe financa dhe është aprovuar nga Kuvendi i Komunës. Pas aprovimit të propozim buxhetit, ai është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor në Ministrinë e Financave.

Buxheti i përgjithshëm është 2,915.921.00€ me 224 punëtorë. Buxheti i kërkuar është aprovuar me Ligjin Nr. 06/1 -133 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2019, edhe pse kërkesat në Drejtorinë e arsimit dhe shëndetësisë kanë qenë më të mëdha.

Gjatë vitit 2019 nuk ka pasur rishikim të buxhetit.

Mos aprovimi i vendeve të punës dhe mos mbështetja me mjete financiare Drejtorinë e Arsimit për Qendrën e arsimit para fillor ka rrezikuar funksionalizimin e çerdhes (kopshtit) së fëmijëve.

Mos funksionalizimi i çerdhes, rrezikon fëmijët e kësaj zone në zhvillimin e fëmijërisë së hershme, në socializmin e tyre dhe në të drejtat elementare të fëmijëve.

Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve (Kopshtit) dhe pajisja e saj me inventarë të nevojshëm, është një investim kapital komunal i bërë para disa viteve dhe ende nuk është funksionalizuar nga mos aprovimi i kërkesës për staf dhe mbështetjen me mjete financiare në arsimin para fillor.

Po ashtu kërkesat për shtim të stafit profesional janë edhe në Drejtorinë e Shëndetësisë për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj qytetarëve, për ruajtjen e shëndetit, në qasje më të lehtë e të barabartë në marrjen e shërbimeve mjekësore të popullsisë.

Sipas mendimit të auditorit Komuna e Hanit të Elezit kërkesat për plotësimin e numrit të punëtorëve në çerdhen e fëmijëve dhe në shtimin e numrit me staf profesional në QKMF janë të arsyeshme.

Rekomandim nr. 1

Komuna e Hanit të Elezit të analizoj dhe të arsyetojnë kërkesat e tyre për mbështetje financiare për plotësimin numrit të punëtorëve. Të kërkohet aprovimi i tyre në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në Ministrinë e Financave dhe në Komisionin për buxhet dhe financa të Kuvendit.

Ministria e Financave tu shqyrtojnë kërkesat e Komunës së Hanit të Elezit me qëllim të funksionalizimit të çerdhes së fëmijëve dhe në shtimin e numrit të punëtorëve profesional në Qendrën Kryesore Mjekësisë Familjare

4.3 Realizimi i shpenzimeve

Ndarjet buxhetore regjistrohen në SIMFK¹. SIMFK ka kontrole të brendshme që shpenzimet nuk mund të realizohen nëse nuk ka fonde buxhetore të mjaftueshme për atë shpenzim. Për shpenzimet që nuk kërkojnë prokurim, zotimi bëhet përmes modulit të Aprovimit, ndërsa për shpenzimet që kërkojnë prokurim, shpenzimet bëhen përmes Modulit të Blerjes. Për blerjet që procedohen përmes modulit të blerjeve, zotimi njihet kur procedohet kërkesa për blerje dhe obligimi regjistrohet kur urdhër blerja të procedohet në sistem.

Projektet kapitale janë të paraqitura në Ligjin për ndarjet buxhetore dhe përmbajnë vlerësimet se sa do të shpenzohen në secilin projekt dhe në secilin vit. SIMFK përmban kufizime ashtu që fondet e alokuara në kategorinë ekonomike të "kapitalit" mund të zotohen vetëm për projekte të tilla. Nëse një projekt kapital duhet të realizohet në vitin e tanishëm, dhe është vonuar, atëherë fondet mund të zotohen në ardhmen për ta përfunduar projektin Kapital. Çfarë do vonese në zbatimin e projekteve dhe ekzekutimin e buxheteve kapitale Organizatat Buxhetore (OB) duhet të hulumtojnë arsyen e vonesës për të kuptuar nëse është e mundur të merren masat korrigjuese.

¹ SIMFK- Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës

Personat përgjegjës të OB dhe analistët e buxhetit duhet rregullisht të shqyrtojnë progresin e projektit me qëllim të ekzekutimit të buxhetit në harmoni me projektet e planifikuara kur projektet nuk mund të zbatohen sipas planit atëherë të përcaktohet mënyra për të përballur parashikimin e buxhetit të mbetur. Vonesat në zbatimin e projekteve dhe ekzekutim të buxhetit kapital duhet t'iu ndihmojnë për të kuptuar kapacitetin e OB në planifikimet e ardhshme.

Komuna e Hanit të Elezit ka ekzekutua buxhetin 97.40% të planifikimit që do të thotë se është realizim i mirë i buxhetit aktual.

Tabela Nr. 2 Buxheti, alokimet, shpenzimet për vitin 2019²

Kodet buxhetore	Buxheti				% ekzekutimit të buxhetit krahas shpenzimeve
	Fillestar	Aktual	Ekzekutuar	I lirë	
1	2	3	4	6	4/3
Nr. i punëtorëve	224	224	224		
Paga dhe mëditje	1,493,148.00	1,493,148.00	1,478,773.44	14,374.56	99.04
Mallra dhe shërbime	263,236.00	262,141.90	261,825.75	315.15	99.88
Shpenzime komunale	54,400.00	54,400.00	54,368.73	31.27	99.94
Subvencione dhe transfere	61,104.00	66,240.27	66,103.40	136.87	99.8
Investimet kapitale	1,044,033.00	1,329,617.91	1,272,137.74	57,480.17	95.77
Totali	2,915,921.00	3,205,548.08	3,133,209.06	72,338.02	97.74

Buxheti aktual ka rritje për 289,672.08€ apo 9.93% se ai fillestar. Rritja ka ardhur nga:

- Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2018 në shumë prej 193,188.88,
- Bartja e granteve 2018 në shumë prej 55,083.68€,
- Bartja e huamarrjes në arsim 2018 në shumë prej 2,405.52€.
- Granti nga Qeveria Japoneze 2019 prej 61,516.00€ dhe
- Transferi i mjeteve të huamarrjes nga Komuna në Ministrinë e Shëndetësisë (MSH) në kuadër të kategorisë mallra dhe shërbime në shumë prej 22,567.00€. Transferi i mjeteve është bërë me datën 24.05.2019 në bazë të Marrëveshjes së bashkëpunimit.

Pjesa më e madhe e shpenzimeve është ekzekutua për paga dhe mëditje për 224 punëtorë apo 47.20% e buxhetit aktual, për mallra dhe shërbime 8.36%, për shpenzime komunale 1.74%, për subvencione dhe transfere 2.1% dhe për investime kapitale është ekzekutua 40.60%.

Shpenzimet më të mëdha të buxhetit për investime kapitale janë realizuar në: ndërtimin e rrugëve lokale, në trotuare, fusha dhe objekte sportive, kanalizime, blerjen e një kamioni etj.

4.3.1 Investimet Kapitale- Projektet

Planifikimi i buxhetit për projekte kapitale për vitet 2019-2021 do të bëhet në formatin e tabelave 4.2. për nivelin komunal (sistemi i PIP-it). Gjatë krijimit/editimit të projekteve të OB duhet pasur

² Raporti përmbledhës i buxhetit- SIMFK

kujdes në regjistrimin e të dhënave sidomos në shumatat totale të projektit, të data e fillimit dhe mbarimit të projektit, cilësia e informatave sipas procedurave që i kërkon Sistemi i PIP-it. Mos planifikimi i duhur i shpenzimeve nëpër nën kategoritë ekonomike, keq klasifikimet paraqesin vështirësi në ekzekutimin e buxhetit. Gjatë planifikimit të projekteve duhet të merren parasysh kapaciteti për zbatimin e tyre, me qëllim të progresit në zbatimin dhe ekzekutimin e buxhetit. Procesi i planifikimit të projekteve kapitale duhet t'iu përmbahet fazave të projektit duke i identifikuar, vlerësuar, përgatitur dhe formuluar projektin, zbatimin, përfundimin dhe shqyrtimin e tyre. Propozimi fillestar i projektit duhet të përfshijë planin dhe buxhetin për fazën përgatitore si dhe planin e zbatimit dhe buxhetin deri në përmbyllje në projektin.

Për vitin 2019 në Tabelën 4.2 Financimi i Investimeve Kapitale Komunale 2019-2021, Komuna e Hanit të Elezit në buxhet ka planifikuar të realizohen 51 projekte kapitale, prej tyre 13 projekte kapitale janë parashikuar për vitin 2020-2021. Mbështetja financiare për këto projekte nëpër programe dhe nën programe është 1,044,033.00€.

Të dhënat për të gjitha këto projekte janë të paraqitura në Sistemin e PIP-it ku secili projekt është i evidentuar me numrin e projektit, përshkrim të projektit dhe fondet e financimit të tyre dhe vlerësimet 2019-2021. Menaxheri i projektit është i obliguar që të dhënat (informatat) për këto projekte të plotësojë në Sistem.

Nga testimi (vëzhgimi fizik) që i kemi bërë sistemit të PIP-it duke filluar nga qasja e zyrtarëve autorizues, kemi gjetur se sistemi nuk është i plotësuar me të dhënat e nevojshme siç parashihen në procedurat e shkruara për përdorimin e sistemit, vetëm për planifikimin e investimeve kapitale ka të dhëna në sistem, por jo edhe për progresin e projekteve dhe përfundimin e tyre.

Edhe pse nuk është bërë regjistrimi i të dhënave në sistem për progresin edhe përfundimin e projekteve ka evidencë për secilin projekt, por jo të përmbledhura se kur ka filluar, progresi i arritur, pagesat dhe përmbyllja e projektit.

Nga paraqitja e të dhënave në Raportin financiar për periudhën 01 Janar-31 Dhjetor 2019³ të Komunës së Hanit të Elezit janë realizuar 41 projekte në shumë prej 1,156,152.14€. Disa projekte janë të vazhduara nga viti 2018 dhe të përfunduara në vitin 2019 dhe disa nuk janë përfunduar në vitin 2019 dhe barten në vitin 2020.

Ka ri alokime të projekteve nga një projekt në tjetrin brenda programit në nën program por edhe nga një program në tjetrin.

Mos regjistrimi i të dhënave në sistem e bënë sistemin jo funksional, kështu që projektet rrezikojnë të mos kenë përshkrim të rreziqeve, mos definimin e qartë të pronarit të pasurisë, mos qartësimin e saktë të detyrave të menaxherit të projektit, në datën e fillimit dhe përfundimit të projektit, mungojnë evidencë përmbledhëse nëpër hapat në të cilat kalon një projekt duke filluar nga vlerësimi i rëndësisë strategjike, ekonomike, financimi dhe Vlerësimi i gatishmërisë së zbatimit. Nga mos regjistrimi i të dhënave në sistem nuk ka gjurmë për realizimin e projekteve kapitale, për dhënien e informatave të sakta, në kohë menaxhmentit.

³ Raporti financiar për periudhën Janar – Dhjetor 2019 i Komunës së Hanit të Elezit



Nga Janari i vitit 2020 dy Udhëzime Administrative kanë hyr në fuqi për Projektet Kapitale:

1. UA-MF - Nr. 04/2019 për definimin e projekteve kapitale dhe klasifikimin e shpenzimeve të projekteve kapitale dhe
2. UA-MF Nr. 06/2019 për kriteret e përzgjedhëse dhe prioritetizimin e projekteve kapitale.

Rekomandim nr.2

Zyrtarët përgjegjës në të ardhmen ta plotësojnë sistemin me të dhënat e nevojshme që të ketë gjurmë të mjaftueshme se si është zhvilluar projekti, a ka pasur vonesa gjatë realizimit, pagesat deri në përmbyllje të projektit.

Të kërkohet nga Ministria e Financave - Departamenti i buxhetit për qasje të zyrtarëve përgjegjës për regjistrimin e të dhënave në sistemin.

4.3.2 Prokurimi

Në bazë të planit të prokurimit për vitin 2019 Komuna e Hanit të Elezit ka parapa të zhvillohen 69 aktivitete të prokurimit. Shuma e parashikuar për këto aktivitete është 1,149,154.20€. Me plan janë planifikuar edhe aktivitetet e prokurimit për investimet kapitale të Komunës.

Tabela Nr. 3 e kontratave të parashikuara për vitin 2019

Nr.	Kontratat e parashikuara	Aktivitetet	Vlera e parashikuar e kontratës
1	Furnizim	20	159,779.20
2	Shërbime	22	172,810.00
3	Punë	27	816,565.00
4	Projektimit	-	-
	Totali i kontratave	69	1,149,154.20

Gjatë vitit 2019 në total janë kryer 76 aktivitete të prokurimit, shuma e kontratave të nënshkruara për këto aktivitete është 1,719,324.57€.

Sipas raportit vjetor të zyrës së prokurimit për vitin 2019, janë zhvilluar aktivitetet e prokurimit:

- Me vlera të minimale janë zhvilluar 27 aktivitete të prokurimit në vlerë prej 22,390.32€;
- Me vlera të vogla dhe të mesme janë zhvilluar 49 aktivitete të prokurimit dhe një aktivitet është ri tenderuar. Shuma e kontratave të nënshkruara është 1,696,934.25€

Shuma e kontratave të realizuara është më e madhe për 969,799.63€ apo 49.62%.

Tejkalimi i realizimit të planit të prokurimit ka ardhur nga Marrëveshjet e bashkëpunimit në mes të Ministrive të Linjës dhe Komunës (bashkëfinancimet) që kanë financua komunën, por procedurat e prokurimit në disa raste i ka kryer Komuna e në disa raste vetë Ministrinë e linjës.

Ne kemi marrë mostër dhe kemi testua projektin:

1. " *Pastrimi i profileve kritike - emergjente të Lumenjve për mirëmbajtje të kapacitetit hartës të ujë rrjedhave* ".

Ky aktivitet është zhvilluar nga Zyra e prokurimit të Komunës me Nr. të prokurimit sipas

e- prokurimit 659-19-346-5-2-1 apo Nr. të brendshëm KKHE -19-015-521. Është kontratë pune, për “Kanalizimin atmosferik dhe fekale në fshatin Seçishtë, Rr. Brigada 164”. Kontrata është nënshkruar me 03.09.2019 në shumë prej 39,992.00€. Është caktua menaxheri i kontratës. Puna nuk është përfundua sipas afatit të liferimit. Raporti i pranimit nga Komisioni është nënshkruar me 12.12.2019, ndërsa Raporti i punës së menaxherit të projekti është përgatitur me 16.12.2019.

Plani i menaxhimit të kontratës (formulari C01) është plotësuar formalisht.

2. Ndërtimi (rihapja zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve lokale në Han të Elezit “

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me Nr. të e-prokurimit 659-196324-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm KKHE -19-034-521. Kontrata është nënshkruar me 29.10.2019, çmimi i kontratës është 66,056.00€. Është caktuar menaxheri i kontratës dhe është bërë Plani i menaxhimit të kontratës me 29.10.2019.

Nuk është përcjell menaxhimi i kontratës, vetëm formalisht është plotësuar formulari standard.

Menaxhimi i kontratës është një aktivitet, i cili kryesisht administrohet nga Menaxheri i Projektit/kontratës, por që në procesin e menaxhimit të kontratës rol të veçantë dhe përgjegjësi të caktuara kanë edhe njësitë tjera të administratës komunale.

Në bazë të testeve që kemi bërë Formularit “ Plani i menaxhimit të kontratës” është nënshkruar në mes të Menaxherit të kontratës dhe Operatorit ekonomik menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, por ky formular nuk është plotësuar me të dhënat e nevojshme që tregojnë progresin e realizimit dhe përmbylljen e të kontratës.

Mosplotësimi i të dhënave në formularin “ Plani i menaxhimit të kontratës” rrezikon që mos të ketë evidenca të plota mbi progresin e realizimit, vonesat, përmbushjen e përfundimin e kontratës dhe në dhënien e informativë të sakta dhe në kohë.

Për menaxhimin e kontratave USAID në vitin 2019 ka përgatitur “Doracakun për menaxhimin e kontratave publike “në kuadër të projektit “ Komuna transparente, efektive dhe llogaridhënëse”, ku jepen shembuj se si menaxhohen kontratat dhe si plotësohet Formulari i “ Plani i menaxhimit të kontratave” .

Nëse formulari i prokurimit nuk plotësohet me të dhëna e nevojshme, dosja e aktivitetit të prokurimit nuk është përmbyll.

Plotësimi i evidencave të secilit projekt kapital ndikon në dhënien e informatave se kur ka filluar dhe kur ka përfunduar projekti, progresin nëpër faza, ngecje nëse ka pasur, pagesat e planifikuara dhe të realizuara, dhe kështu që e kemi të lehtë të dimë se sa është vlera totale e një projekti.

Rekomandimi nr. 3

Menaxheri i projektit ta plotësoj formularin“ Planin e menaxhimit të kontratës “ sipas hapave në formular.

Menaxheri i prokurimit të monitoroj planin e menaxhimit të kontratës me qëllim që ta përmbyll aktivitetin e prokurimit me të dhënat e domosdoshme.

4.3.3 Bashkëfinancimet

Komuna ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi për bashkëfinancim me Ministrinë e Linjës siç janë Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Administrimit Lokal etj.

Në vitin 2018 MAPL ka bërë matjen e performancës në 38 komuna përmes Sistemit për Menaxhimin e Performancës së Komunave (SMPK) ku si kritere për performancë ka marrë kompetencat vetanake në 14 fusha të shërbimeve komunale.

Raporti i performancës komunale (RPK) prezanton rezultatet e performancës komunale, duke u bazuar në të dhënat e grumbulluara përgjatë një viti dhe analizës së tyre përmes raporteve individuale të dërguara nga komunat. Me anën e këtij raporti, MAPL thekson rëndësinë e ofrimit të shërbimeve dhe në veçanti informon qytetarët për pritjet e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve nga institucionet lokale.

Nga kjo performancë ka përfituar edhe Komuna e Hanit të Elezit me fonde stimuluese në investime kapitale ku është nënshkruar Marrëveshje bashkëpunimi në mes dy institucioneve.

Ne për test kemi marrë këto bashkëfinancime si:

1. “Ndërtimi (rihapja zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve lokale në Han të Elezit “

Projekti Ndërtimi (rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve lokale në Han të Elezit është bërë me bashkëfinancim me MAPL dhe DEMOS. Me 27,14% është bërë financimi nga MAPL, ndërsa pjesa tjetër 72,86% është financua nga Komuna.

Në planifikimin e buxhetit për investime kapitale të MAPL për vitin 2019 ka planifikuar në sistemin e PIP-it projektin me Nr. të 15828. Nga MAPL janë plotësuar të dhënat në sistem të PIP-it: Përshkrimi dhe objektivat e projektit, Organizatën buxhetore, nën programi, menaxherin e projektit, Statusi i propozimit statusi i projektit, data e fillimit dhe mbarimit të projektit. Buxheti vjetor i Projektit është 48,430.00€, pagesa është ekzekutua në nëntor 2019 në shumë prej 48,430.00€.

Në planifikimin e buxhetit për investime kapitale edhe Komuna për vitin 2019 ka parapa në sistemin e PIP-it këtë projekt me Nr. 48910 dhe shuma e projektit është 130,000.00€.

Për këtë projekt nuk janë të regjistruara të dhëna në sistem të PIP-it nga Komuna.

Ky projekt në sistem të PIP-it është i regjistruar me dy projekte të ndryshme për të njëjtin qëllim nga dy institucione. Procedurat e prokurimit kryhen nga Komuna, menaxhimi i projektit bëhet nga Komuna ndërsa MAPL bënë monitorimin e projektit.

2. “ Pastrimi i profileve kritike - emergjente të Lumenjve për mirëmbajtje të kapacitetit bartës të ujë rrjedhave”.

Ky projekt ka filluar në vitin 2018 në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit (MM) në mes të MMPH dhe Komunës. MM është nënshkruar në mes palëve me Nr. 583 të datës 10.08.2018 në shumë prej 50,000.00€ për vitin fiskal 2018. Në marrëveshje parashihet që nëse projekti nuk përfundohet brenda vitit fiskal të gjitha obligimet i kalojnë Komunës. Projekti është i planifikuar në investimet kapitale të vitit 2018 të MMPH me nr. të projektit 13116 “ Pastrimi i Lumit Lepenc nga mbeturinat e Azbestit ” në shumë prej 50,000€. Projekti nuk ka përfundua gjatë vitit 2018 dhe është bartur në vitin 2019.

Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga Komuna në vitin 2018. Ky projekt ka pasur vështirësi në ekzekutim.

3. Rregullimi i stadiumit të Hanit të Elezit

Projekti "Stadiumi i qytetit të Hanit të Elezit" është planifikuar në investimet kapitale të MKRS. Projekti është i regjistruar në sistemin e PIP me Nr. të projektit 18310 në shumë prej 50,000.00€. Është caktuar Menaxher i projektit nga MKRS. Projekti ka një përshkrim dhe objektiva. Data e fillimit të projektit është 16.03.2019 dhe e përfundimit është 20.12.2020. Totali i shpenzimeve është 50,000.00€. Në sistem nuk ka të dhëna për progresin fizik të projektit dhe kur është nënshkruar kontrata. Pasi aktiviteti me procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga MKRS.

3a. Për realizimin e këtij projekti edhe Federata e futbollit të Kosovës(donator) ka financuar këtë projekt dhe që është paguar në shumë prej 30,500.00€.

Për të njëjtin projekt Komuna e Hanit ka financua dhe ka pagua shumën prej 88,101.80€.

Për realizimin e projektit" shuma e përgjithshme deri në finalizim është 218,617.45€.

Memorandumet e Mirëkuptimit kanë mangësi në përpilimin e tyre, sidomos në pronësinë e projektit, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve etj. Nuk ka kriteret të qarta rreth bashkëfinancimeve nga Ministrive të linjës dhe komunës.

Këto projekte, në masë të madhe financohen nga ministria, por nuk monitorohen mjaftueshëm nga ana e ministrisë. Në raste të caktuara, memorandumet për bashkëfinancim bëhen para se të jenë krijuar parakushtet për fillimin e projektit, siç janë: ekzaminimet në terren, projektet ekzekutive, zgjidhja e çështjeve pronësore, marrja e lejeve/pëlqimeve për kycje në kanalizim, ujësjellës, rrjet elektrik, etj.

Për shkak të situatës së pandemisë me Covit/19 nuk kemi mundur të komunikojmë me ministrinë e linjës që të marrim informata se si bëjnë ato monitorimin e projekteve.

Nuk mund të japim vlerësim se sistemi i kontrollit funksionon.

4.4 Autorizimi, regjistrimi, pranimi dhe monitorimi i Shpenzimeve

Për autorizimin, regjistrimin dhe monitorimin e shpenzimeve zyrtarët kanë të deponuar nënshkrimet në thesar. Pasi është komunë e vogël zyrtarët përveç detyrave që i kanë të përcaktuar me akt emërim ata ushtrojnë edhe detyra shtesë. Me vendim zyrtarët kryejnë detyrat shtesë në ciklin e shpenzimeve.

Në bazë të testeve të kryera konstatojmë se të gjitha shpenzimet janë të autorizuara nga personat përgjegjës, të regjistruara të pranuar dhe monitoruara.

Në këtë fushë mund të themi se sistemi i kontrollit funksionon.

4.5 Pasuria

Pasuritë duhet të regjistrohen në një regjistër të përgjithshëm të pasurive dhe regjistrin kontabël në çdo kohë sipas Rregullores Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë financiare dhe jo financiare në Organizata Buxhetore(OB) .

Pasuria e OB sipas klasifikimit kontabël përfshin pasurinë jo financiare kapitale, jo kapitale dhe stoqet. Të gjithë zyrtarët janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë që është në posedim dhe mbikëqyrje të tij kundrejt humbjeve, vjedhjeve dhe keqpërdorimit të pa autorizuar.

Komuna e Hanit të Elezit ka një regjistër të përgjithshëm të pasurive mbi vlerën 1,000.00€ në modulën e pasurisë të regjistruara në SIMFK dhe në programin e - pasuria nën vlerën 1,000.00€.

Mirëpo për regjistrimin e pasurisë në sistemin e e-pasurisë zyrtarët komunal kanë problem në qasje. Për shkak të qasjes dhe ndryshimit në sistemin e e-pasurisë të dhënat e regjistruara nuk janë ruajtur. Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare në fund vit, sistemi nuk e ka paraqitur gjendjen reale dhe nuk ka qenë e mundur tu besohet informatave të gjeneruara të këtij sistemi.

Për zgjidhjen e këtij problemi komuna e ka barazuar gjendjen duke përdorur metoda tjera (Excelin) dhe është dashtë të kryhet një punë e dyfishtë. Mirëpo edhe sa ishim në auditim ky problem nuk është zgjidhur, ky është një rrezik i vazhdueshëm, për menaxhimin e pasurisë nën 1,000.00€.

Sipas zyrtarëve komunal sistemi e-pasuria nuk është funksional sepse nuk mundëson zhvlerësimin dhe ka gabime teknike.

Komuna e Hanit të Elezit ka caktuar komisionin prej tre anëtareve për inventarizimin e pasurisë. Për vitin 2019 është kryer inventarizimi i pasurisë nga komisioni i inventarizimit.

Pas inventarizimit është caktuar komisioni i vlerësimit të pasurisë mirëpo komisionit nuk ka përfundua vlerësimin gjatë vitit 2019 .

Komuna ka caktuar komisionin për tjetërsimin e pasurisë. Komisioni ka kryer punën dhe ka përgatitur Raportin për tjetërsimin e pasurisë.

Sipas Raportit Vjetor Financiar 2019, vlera e pasurisë jo kapitale (me vlerë nën 1,000.00€) është 203,250.37€, stoqet 28,042.73€, ndërsa pasuritë kapitale (me vlerë mbi 1,000.00€) janë 15,490.368.00€.

Sipas Raportit të vlerës aktuale të Pasurisë të regjistruar në SIMFK shohim se në sistem janë regjistruar pasuria sipas klasifikimit kontabël, emrit të klasifikimit, çmimin e vlerës aktuale, vlerën origjinale, amortizimin dhe vlerën neto në libra. Vlera origjinale e përgjithshme e pasurisë është 651,989.33€, amortizimi i pasurisë është 582,778.13€ dhe vlera neto në libra është 69,211.20€.

Pjesa më e madhe e pasurisë është amortizuar, por është në përdorim. Pasuria nuk është rivlerësuar në sisteme (e pasuria dhe SIMFK).

Problem për Komunën mbetet rivlerësimi i pasurisë. Komuna ka pasuri e cila është në përdorim

por në regjistra nuk ka vlerë. Edhe kjo çështje duhet të adresohet që të bëhet rivlerësimi i pasurisë.

Një çështje tjetër duhet ngritur te bashkëfinancimet është te projektet kapitale (pasuria) regjistrohet në Ministrinë e linjës në investimet në vijim e pas pranimit teknik të projektit nga Ministria atëherë projekti (Rrugët, fusha të sportit, kanalizimet) kalon në pronësi të Komunës.

Nuk ka procedura të shkruara se si do të bëhet bartja, ka vonesa në kapitalizmin e pasurisë.

Mungesa e regjistrit të përgjithshëm të pasurive nga komisioni i vlerësimit, inventarizimi i pasurive në fund të vitit, zhvlerësimi i pasurisë dhe bartja e pasurisë nga Ministrinë e linjës në komunë, ndikon në informata jo të plota, të sakta dhe të vlefshme për menaxhmentin si dhe paraqitjen e drejtë të tyre në pasqyra financiare.

Nuk mund të themi se sistemi i kontrollit funksionon siç është përcaktuar sipas Rregullores Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë financiare dhe jo financiare në Organizata Buxhetore (OB) .

Rekomandimi nr. 4

Menaxhmenti i Komunës të ngritë kontrollin në menaxhimin e pasurisë duke i freskuar të dhënat në regjistrat e pasurisë. Të themelohet dhe të kërkoj Raporte nga komisioni i inventarizimit, vlerësimit, tjetërsimit, asgjësimit të pasurisë dhe të dijë vlerën e saktë të pasurisë financiare.

Në bashkëpunim me Thesarin dhe MAP të cilët menaxhojnë dy sistemet e regjistrimit të pasurisë të kërkojnë informata rreth rivlerësimit të pasurisë.

5. Zbatimi i rekomandimeve të Departamentit të Auditimit të Brendshëm

DAB ka kryer auditimin e brendshëm në vitin 2017. Nga ky auditim janë dhënë gjashtë (6) rekomandime, prej tyre tre (3) janë zbatuar dhe tre (3) janë zbatuar pjesërisht.

6. KONKLUZIONET

Në përgjithësi mund të themi se Kontrolli i Brendshëm i dizajnuar nga menaxhmenti funksionon, por ka nevojë për përmirësim në:

- Funkcionalizimin e Çerdhes (Kopshtit) të fëmijëve me staf;
- Shtimin e numrit të punëtorëve me staf profesional në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare;
- Plotësimin e të dhënave në sistemin e PIP-it për të gjitha projektet kapitale;
- Plotësimin e të dhënave në formularin “Plani i menaxhimit të kontratës”;
- Bashkëfinancimet dhe
- Menaxhimin e pasurisë .

—

—

—

—

—

7. PLANI I VEPRIMIT

Me datë 13.05.2020 kemi lëshuar Draft raportin e Auditimit me të gjeturat dhe rekomandimet. Kemi dërguar në mënyrë elektronike formularët “të gjeturat dhe rekomandimet dhe planin e veprimit me qëllim të dhënies së komenteve të menaxhmentit dhe aftatin e përmbushjes së rekomandimeve.

Kemi pranuar komentet e menaxhmentit dhe planin e veprimit me datë 11.06.2020, të cilat ia bashkangjesim Raportit final.

8. FALËNDERIMET

Gjatë kryerjes se këtij auditimi, ekipit iu është ofruar bashkëpunimi i mirë nga personat përgjegjës.

Ne çmojmë lartë qëndrimin pozitiv dhe besojmë se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Annexi I

Të gjeturat, rekomandimet dhe komentet e menaxhimentit

Emri i Auditimit: Funkcionimi i Komunës së Hanit të Elezit

NR	TË GJETURAT	KLASIFIKIMI I TË GJETURAVE	REKOMANDIMI	KOMENTET E MENAXHIMENTIT	KONKLUZIONIT
1	<p>2</p> <p>Gjatë vitit 2019 Kuvendi i Komunës ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta. Për çdo takim mbahet procesverbali, janë miratuar nga anëtarët e Kuvendit.</p> <p>Gjatë vitit 2019 Kuvendi Komunal ka marrë 42 vendime, ka aprovuar katër (4) Rregullore dhe ka përgatitur Raportin vjetor të punës për vitin 2019.</p>	3	4	5	6
1	<p>Komuna ka mbledhë informatat nga të gjitha njësitë kërkuese për hartimin e propozim buxhetit për vitin 2019-2021, ka mbajtur dëgjimet buxhetore me qytetar. Buxheti është diskutuar në Komitetin për politikë dhe financa dhe është aprovuar nga Kuvendi i Komunës edhe pse kërkesat për vende të punës në Drejtorin e arsimit ka pasur për Qendrën e arsimit para fillor në funksionalizimin e çerdhes (kopshtit) së fëmijëve dhe në Drejtorinë e shëndetësisë.</p>	U			
2	<p>Buxheti fillestar i Komunës është 2,915,921.00€ ndërsa buxheti aktual është 3,205,548.08€. Ka rritje të buxhetit në mes buxhetit aktual dhe fillestar. Rritja ka ndodhur nga barja e të hyrave vetanake nga viti 2018, barja e granteve 2018, barja e huamarrjes në arsim 2018, Granti nga Qeveria Japoneze 2019 dhe transferi i mjeteve të huamarrjes nga Komuna në Ministrinë e Shëndetësisë.</p> <p>Komuna e Hanit të Elezit ka ekzekutua buxhetin 97.40% të planifikimit që do të thotë se është realizim i mirë i buxhetit aktual.</p>	L	<p><i>Rekomandim nr. 1</i></p> <p><i>Komuna e Hanit të Elezit të analizoj dhe të arsyetojnë kërkesat e tyre për mbështetje financiare për plotësimin numrit të punëtorëve. Të kërkojnë aprovimi i tyre në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në Ministrinë e Financave dhe në Komisionin për buxhet dhe financa të Kuvendit.</i></p>	<p>Pajtohem</p>	
		M			

	<p>Shpenzimet më të mëdha të buxhetit janë realizuar në investime kapitale si: ndërtimin e rrugëve lokale, në trotuare, fusha dhe objekte sportive, kanalizime, blerjen e një kamioni etj</p>		<p><i>shitim e marrit të punëtorëve profesional në Qendrën Kryesore Mjekësive Familjare</i></p>		
5	<p>Nga testimi (vëzhgimi fizik) që i kemi bërë sistemit të PIP-it duke filluar nga qasja e zyrtarëve autorizues, kemi gjetur se sistemi nuk është i plotësuar me të dhënat e nevojshme siç parashihën në procedurat e shkruara për përdorimin e sistemit. Sistemi me të dhëna është plotësuar vetëm për planifikimin e investimeve kapitale, por jo edhe për progresin e projekteve dhe përfundimin e tyre.</p> <p>Edhe pse nuk është bërë regjistrimi i të dhënave në sistem për progresin edhe përfundimin e projekteve ka evidenca për secilin projekt, por jo të përmbledhura se kur ka filluar projekti, progresi i arritur, pagesat dhe përmbyllja e projektit.</p> <p>Nga paraqitja e të dhënave në Raportin financiar për periudhën 01 Janar-31 Dhjetor 2019 të Komunës së Fhanit të Elezit janë realizuar 41 projekte në shumë prej 1,156,152.14€.</p> <p>Disa projekte janë të vazhduara nga viti 2018 dhe të përfunduar në vitin 2019 dhe disa nuk janë përfunduar në vitin 2019 dhe barten në vitin 2020.</p> <p>Ka ri alokime të projekteve nga një projekt në tjetrin brenda programit në nën program por edhe nga një program në tjetrin.</p>	L	<p><i>Rekomandim nr.2</i></p> <p><i>Zyrtarët përgjegjës në të ardhmen ta plotësojnë sistemin me të dhënat e nevojshme që të ketë gjurmë të njafueshme për zhvillimin e projektit deri në përmbyllje.</i></p> <p><i>Të kërkohet nga Ministria e Financave - Departamenti i buxhetit për qasje të zyrtarëve përgjegjës për regjistrimin e të dhënave në sistem.</i></p>	Pajtohemi	
	<p>Në bazë të planit të prokurimit për vitin 2019 Komuna ka parapa të zhvillohen 69 aktivitete të prokurimit Shuma e parashikuar për këto aktivitete është 1,149,154.20€. Gjatë vitit 2019 në total janë kryer 76 aktivitete të prokurimit, shuma e kontratave të nënshkuara për këto aktivitete është 1,719,324.57€.</p> <p>Tejkalimi i realizimit të planit të prokurimit ka ardhur nga Marrëveshjet e bashkëpunimit në mes të Ministrive të Linjës dhe Komunës (bashkëfinancimet) që kanë financuar komunën, por procedurat e prokurimit në disa raste i ka kryer Komuna e në disa raste vetë Ministrinë e linjës.</p> <p>Në bazë të testeve që kemi bërë disa aktiviteteve të prokurimit me bashkëfinancim, Formulari “ Plani i menaxhimit të kontratës” është nënshkruar në mes të Menaxherit të kontratës dhe Operatorit ekonomik menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, por ky formular nuk është plotësuar me të dhënat e nevojshme që tregojn progresin e realizimit dhe përmbylljen e të kontratës</p>	L	<p><i>Rekomandimi nr. 3</i></p> <p><i>Menaxheri i kontratës ta plotësoj formularin “ Planin e menaxhimit të kontratës “ sipas hapave në formular.</i></p> <p><i>Menaxheri i prokurimit të monitoroj planin e menaxhimit të kontratës me qëllim që ta përmbyll aktivitetin e prokurimit me të dhënat e domosdoshme.</i></p>	Pajtohemi	

	<p>Komuna ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi për bashkëfinancim me Ministrinë e Linjës siç janë Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Administrimit Lokal etj. Memorandumet e Mirëkuptimit kanë mangësi në përfillimin e tyre, sidomos në pronësinë e projektit, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve etj. Nuk ka kritere të qarta rreth bashkëfinancimeve nga Ministrive të Linjës dhe komunës.</p> <p>Këto projekte, në masë të madhe financohen nga ministria, por nuk monitorohen mjaftueshëm nga ana e ministrisë. Në rastet e caktuara, memorandumet për bashkëfinancim bëhen para se të jenë krijuar parakushtet për fillimin e projektit, siç janë: ekzaminimet në terren, projektet ekzekutive, zgjidhja e çështjeve profesore, marrja e lejeve/pëlqimeve për kyçe në kanalizim, ujësjellës, rrjet elektrik, etj.</p> <p>Për shkak të situatës me Covid/19 nuk kemi mundur të komunikojmë me ministrinë e Linjës që të marrim informata se si bëjnë ato monitorimin e projekteve dhe nuk mund të japim mendimin.</p>			
	<p>Në bazë të testeve të kryera konstatohet se të gjitha shpenzimet janë të autorizuara nga personat përgjegjës, të regjistruara të pranuar dhe monitoruara.</p>	U		
	<p>Komuna e Hanit të Elezit ka një regjistr të përgjithshëm të pasurive mbi vlerën 1,000.00€ në modulën e pasurisë të regjistruara në SIMFK dhe në programin e - pasurisë nën vlerën 1,000.00€.</p> <p>Për regjistrimin e pasurisë në sistemin e e-pasurisë zyrtarët komunal kanë problem në qasje. Për shkak të qasjes dhe ndryshimit në sistemin e e-pasurisë të dhënat e regjistruara nuk janë ruajtur. Çjatatë përgatitjes së pasqyrave financiare në fund vit, sistemi nuk e ka paraqitur gjendjen reale dhe nuk ka qenë e mundur tu besohet informatave të gjeneruara të këtij sistemi, por zyrtaret kanë përdorur Excelin dhe kanë barazuar gjendjen. Edhe sa ishim në auditim ky problem nuk është zgjidhur, ky është një mezik i vazhdueshëm. Sistemi e-pasuria nuk është funksional sepse nuk mundëson zhvlerësimin dhe ka gabime teknike.</p> <p>Për vitin 2019 Komuna, ka caktuar komisionin për inventarizimin e pasurisë. Është bërë inventarizimi i pasurisë nga komisioni i inventarizimit.</p> <p>Pas inventarizimit është caktuar komisioni i vlerësimit të pasurisë mirëpo komisionit nuk ka përfundua vlerësimin.</p>	L	<p>Rekomandimi nr. 4</p> <p><i>Menaxhment i Komunës të ngritë kontrollin në menaxhinin e pasurisë duke i freskuar të dhënat në regjistrat e pasurisë. Të themeloj dhe të kërkoj Raporte nga komisioni i inventarizimit, vlerësimit, fjetërsimit, asgjësimit të pasurisë dhe të dijë vlerën e saktë të pasurisë/financiare.</i></p> <p><i>Në bashkëpunim me Thesarin dhe MAP të cilët menaxhojnë dy sistemet e regjistrimit të pasurisë të kërkojnë informata rreth rrvlerësimit të pasurisë.</i></p>	Pajtohemi
	<p>Komuna ka caktuar komisionin për fjetërsimin e pasurisë. Komisioni ka kryer punën dhe ka përgatitur Raportin për fjetërsimin e pasurisë.</p>			

	<p>Pjesa më e madhe e pasurisë është amortizuar, por është në përdorim. Pasuria nuk është rrvlerësuar në sisteme (e - pasuria dhe SIMFK).</p> <p>Te bashkëfinancimet projektet (pasuria) regjistrohet në Ministrinë e linjës në investimet në vijim e pas pranimit teknik të projektit nga Ministria atëherë projekti (Rrugët, fusha të sportit, kanalizimet) kalon në pronësi të Komunës. Ka vonesa në kapitalizimin e pasurisë</p>				
--	--	--	--	--	--

Përgatitur nga: Fatime Jahiu, Udhëheqëse e auditimit

Data: 12.05.2020

Pranimi i komenteve nga : Komuna e Hanit të Elezit

Data: 10.06.2020



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - MUNICIPALITY
ILANI I ELEZIT



Nr.02/ 3132 /2020

DATA:	10.06.2020
PËR:	Fatime Jahiu, Udhëheqëse e Auditimit Departamenti i Auditimit të Brendshëm në MFT Ministria e Financave dhe Transfereve
CC:	Xhevat Bekteshi Drejtor i Departamentit të Auditimit të Brendshëm
NGA:	Rufki Suma Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
LËNDA:	Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm nga komuna e Hanit të Elezit

E nderuar,

Bazuar në draft raportin e auditimit të brendshëm me nr. protokollit 04/55-1 të datës 13.05.2020 të kryer nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Financave dhe Transfereve lidhur me të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna, komuna e Hanit të Elezit pajtohet me të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna dhe njëkohësisht ka përgatitur edhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

Po ju dërgojmë:

- Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm nga komuna e Hanit të Elezit

Me respekt,

Aneksi II

Plani i veprimt për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm nga komuna e Hanit të Elezit

Nr.	Rekomandimet	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar për përfundim	Personat përgjegjës
1	<p><i>Komuna e Hanit të Elezit të analizoj dhe të arsyetojnë kërkesat e tyre për mbështetje financiare për plotësimin numrit të punëtorëve. Të kërkohet aprovimi i tyre në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në Ministrinë e Financave dhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit.</i></p> <p><i>Ministria e Financave ta shqyrtojë kërkesën e Komunës së Hanit të Elezit me qëllim të funksionalizimit të çerdhes së fëmijëve dhe në shtimin e numrit të punëtorëve profesional në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare.</i></p>	<p>Komuna e Hanit të Elezit ka bërë kërkesa të vazhdueshme që (2) dy vite në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrinë e Financave dhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës lidhur me mbështetjen financiare për plotësimin e numrit të punëtorëve me qëllim të funksionalizimit të çerdhes së fëmijëve dhe në shtimin e numrit të punëtorëve profesional në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare.</p> <p>- Kërkesat nga Kryetari i Komunës janë me nr. protokolli si në vijim: Nr.02/5706/2018 e datës 12.07.2018; Nr.02/991/2020 të datës 11.02.2020; Nr.02/1248/2020 të datës 20.02.2020; Nr.02/991/2020 të datës 11.02.2020; Nr.02/1248/2020 të datës 20.02.2020.</p> <p>-Kërkesat nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si në vijim: Nr.07/3104/2018 e datës 11.04.2018; Nr.07/5706/2018 e datës 12.07.2018; Nr.07/8392/2018 e datës 08.10.2018; Nr.07/4489/2019 e datës 22.05.2019; Nr.07/1452/2020 e datës 25.02.2020; Nr.07/3100/2020 e datës 09.06.2020.</p> <p>-Kërkesat nga Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Ririsë dhe Sportit me nr. protokolli si në vijim: Nr.05/4299/2019 të datës 25.05.2018; Nr.05/5106/2016 të datës 21.06.2018; Nr.05/1066/2020 të datës 13.02.2020; Nr.05/1067/2020 të datës 13.02.2020; Nr.05/2376/2020 të datës 22.04.2020</p>	2020-2021	Kryetari i Komunës; Drejtoria e DKARS-ës; Drejtoria e DSHMS-së

2	<p>Zyrtarët përgjegjës ta plotësojnë sistemin me të dhënat e nevojshme që të ketë gjurmë të njafshme për zhvillimin e projektit deri në përmbyllje.</p> <p>Të kërkohet nga Ministria e Financave - Departamenti i buxhetit për qasje të zyrtarëve përgjegjës për regjistrimin e të dhënave në sistemin.</p>	<p>Fillimisht do të bëhet kërkesë në Ministri të Financave për mbajtjen e trajnimit për sistemin e PJP-it me të dhënat e nevojshme për zhvillimin e projektit deri në përmbyllje jo vetëm për pjesën fillestare të planifikimit të buxhetit, por edhe për pjesën e procesit të monitorimit të projekteve, pastaj do të kërkohet nga MF-ja që të kenë zyrtarët qasje non-stop, për të plotësuar projektet nga fillimi i punëve deri në përfundim siç është kërkuar nga ekipi i auditimit të brendshëm.</p>	Dhjetor 2020	Ministria e Financave dhe Transfereve; Menaxheri i projekteve
3	<p>Menaxheri i kontratës ta plotësojë formularin "Planin e menaxhimit të kontratës" sipas hapave në formular.</p> <p>Menaxheri i prokurimit të monitoroj planin e menaxhimit të kontratës me qëllim që ta përmbyll aktivitetin e prokurimit me të dhënat e domosdoshme.</p>	<p>Me marrjen e rekomandimeve të ekipit të auditorëve të brendshëm nga MFT, ne do t'i kushtojmë rëndësi dhe vëmendje të veçantë plotësimit dhe rifreskimit të planit për menaxhimin e kontratës sipas kushteve të kontratës.</p> <p>Pas rifreskimit të planit për menaxhimin e kontratës nga menaxheri i kontratës, menaxheri i prokurimit do të monitoroj procesin e planit të kontratës sipas hapave dhe kushteve të kontratës.</p>	Qershor 2020	Menaxherët e kontratave; Zyra e prokurimit
4	<p>Menaxhmenti i Komunës të ngritë kontrollin në menaxhimin e pasurisë duke i freskuar të dhënat në regjistrat e pasurisë. Të themelohet dhe të kërkohet Raporte nga komisioni i inventarizimit, vlerësimit, tjetërimit, asgjësimit të pasurisë dhe të dijë vlerën e saktë të pasurisë financiare.</p> <p>Në bashkëpunim me Thesarin dhe MAP të cilët menaxhojnë dy sistemet e regjistrimit të pasurisë të kërkohet informata rreth rivlerësimit të pasurisë</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kërkesë MAP-it për përmirësimin e gjendjes së të dhënave të pasurisë nën 1000 € dhe materialit shpenzues, ku pas avancimit të sistemit të E-pasurisë janë paraqitur në një gjendje jo reale (te ndryshme nga gjendja faktike). 2. Barkodimi i aseteve pa barkode (për shkak se kur është bërë renovimi i objektit komunal në vitin 2015 iu kanë humbur barkodet) 3. Të bëhet vlerësimi i aseteve komunale nga komisioni i vlerësimit të tre sektorëve; administratës, të arsimit dhe shëndetësisë që nuk janë të regjistruara në sistemin E-pasuria. 4. Pasi të bëhet vlerësimi nga komisioni për vlerësimin e pasurisë jo financiare (caktimi i çmimeve), zyrtari i depozitave të regjistruar në sistemin E-pasuria. 5. Zyrtari i zhvlerësimit (amortizimit) të bëjë regjistrimin e aseteve për t'i futur në sistemin për caktimin e shkallës së amortizimit sipas Rregullores së MF-së numër 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore. 	<p>Shtator 2020</p> <p>Tetor 2020</p> <p>Tetor 2020</p> <p>Nëntor 2020</p> <p>Dhjetor 2020</p>	<p>Drejtoria e Administratës, Zyrtari i Depozitave, Komisioni i vlerësimit të aseteve, Komisioni i tjetërimit, Zyrtari i Zhvlerësimit (Amortizimit)</p>